REPUBLIKA E SHQIPËRI
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 59 prot. Kamëz, më 19 . 04.2022

# V E N D I M

Nr. 52 .Datë 19 / 04 2022
MBI

**" MIRATIMIN E MARRËVESHJES PARAPRAKE PËR KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË SIPAS SHOJCËS "D" DHE KONTRATËS PËR KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË (MODEL) SIPAS SHTOJCËS "Ç" PËR OBJEKTET KOLEVTIVE, (PALLATET E VALIASIT) TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019 NGA BASHKIA KAMËZ TEK PËRFITUESI "**

**Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 19.04.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.49 Datë 15.04.2022** në mbështetje të ligjit nr.139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore "; Aktin Normativ nr. 09 datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasoja vetëfatkeqësisë natyrore" dhe aktet nënligjore për zbatimit të tij; Vendimin nr. 750, datë 27.11.2019 " Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë " të ndryshuar; Vendim Nr. 904, datë 24.12.2019 " Për përcaktimin e rregullave, të kategori veprioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjese dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit"; Vendim Nr.5, datë 06.01.2020 " Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga program I granteve të rindërtimit dhe projektet model "; Vendim Nr.8, datë 06.01.2020 " Për përcaktimin e kushteve dhe të kritereve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje"; Vendim Nr. 887, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedures së për shpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe proçedures së miratimit të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore "; Vendimit nr.22, datë 13.02.2020, të Këshillit Bashkiak Kamëz " Për miratimin e manualit të proçedurave për përfitimin nga programet e rindërtimit"; **Këshilli Bashkiak Kamëz ";**

## V E N D O S I:

1. Miratimin e marrëveshjes paraprake për kalimin e së drejtës së pronësisë sipas shojcës "D" dhe kontratës për kalimin e së drejtës së pronësisë (model) sipas shtojcës "Ç" për objektet kolevtive, (Pallatet e Valiasit) të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019 nga Bashkia Kamëz tek përfituesi.

2. Ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Strehimit, Drejtoria e Çështjeve Ligjore, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit, dhe Drejtoria e Rindërtimit për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë.**

**Kryetar Këshilli**
**HYSEN KOLDASHI**